



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
Mbledhja nr. 35.
Prishtinë, më 14.03.2012 në ora 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Goran Marinkovic, Elmi Reçica, Albert Kinolli, Lumnije Morina, Lirije Kajtazi, , Jasmina Živkovic, Jelena Bontic, dhe

Munguan: Mufera Sinik, Glauk Konjufca, Petar Miletic, Rasim Demiri dhe Etem Arifi.

Emrat e të ftuarve dhe pjesëmarrësve tjerë: përfaqësuesja nga OSB, Lejla Selimi ,përfaqësuesja nga zyra Zvicerane Sakibe, përfaqësues nga zyra e ICO-së Dejan Cosic, përfaqësues nga zyra e KDI-së Shkumbim Beqiri dhe përfaqësuesi nga mediat e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Emrat e stafit mbështetës të komisionit: Koordinatorë Natasa Prica-Tisma ,zyrtare e lartë ligjore, Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Goran Marinkovic, kryetari i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës.
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.02.2012
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-97 për Bibliotekat në Republikën e Kosovës, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-83 për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkuesve, me raportin e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente.
5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-098 për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror, me raportin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastruktur, Tregti dhe industri, me amendamente.
6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-168 për Turizmin dhe shërbimet turistike, me raportin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe industri, me amendamente.
7. Te ndryshme

Kryesuesi - konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryesuesi – propozoi që rendi i ditës të plotësohem me pikën Përfundimi i dalë nga Komisionit për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis Hapësinor në Projektligjin nr. 04/L-062 për fshatin Hoçë e Madhe dhe u konstatua se u miratua rendi i ditës me shumicë të votave me plotësim dhe ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 28.02.2012.

Kryesuesi -konstatoi se komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së datës 28.02.2012, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-97 për Bibliotekat në Republikën e Kosovës, me raportin e Komisionit funksional për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media, me amendamente.

Kryesuesi, theksoi se lidhur me Projektligjin nr. 04/L-97 për Bibliotekat në Republikën e Kosovës kemi dy propozim amendamente, Raporti me amendamente të Komisionit funksional dhe propozim amendamentet e GP SLS dhe të GP 6+ .

Qëndrimi i tij ishte se me propozim amendamentet e GP- SLS dhe GP- 6+, në Këshillin Drejtues të Bibliotekës Kombëtare sigurohet pjesëmarrja e të gjitha komuniteteve, që do thotë se mbrojnë shoqërinë multietnike kosovare dhe janë të bazuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Kryesuesi propozoi që komisioni të deklarohej që të votohen amendamentet e komisionit funksional dhe veçmas amendamentet e grupeve parlamentare, andaj hapi debat.

Elmi Reçica – ishte i mendimit se Komisioni në mbledhjen e kaluar i ka miratuar amendamentet e propozuara nga Komisioni funksional ndërsa sot do të votohen amendamentet e grupeve parlamentar.

Jasmina Zivkovic- Ajo propozoi që amendamentet e GP – SLS dhe GP 6 + të votohen në emër të komisionit për Komunitete dhe Kthim.

Kryesuesi - konstatoi se pas diskutimeve të shumta lidhur me propozim amendamentet e GP- SLS dhe GP – 6+, se të njëjtat u miratuan si amendamente të komisionit, me katër vota pro dhe tri kundër, dhe nxori këtë:

Përfundim

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim shqyrtoi Projektligjin nr.04/L-97 për bibliotekat në Republikën e Kosovës, me Raportin me amendamentet e propozuara të Komisionit funksional dhe të njëjtat i ka miratuar, përveç amendamentit 8, dhe propozoi të miratohen me këto propozim ndryshime:

Amendamenti 1

Neni 9

Këshilli drejtues i bibliotekës kombëtare

Neni 9 paragrafi 1.1 ndryshon dhe bëhet:

Fjala „pesë”(5) zëvendësohet me fjalën „shtatë“(7)

Amendamenti 2

Nenit 9 paragrafi 1.3 i shtohet paragrafi i ri **1.4** dhe thotë:

1.4 „Njëri nga shtatë (7) anëtarët e Këshillit të Bibliotekës Kombëtare duhet të jetë i komunitetit serb, dhe njëri prej shtatë (7) anëtarëve duhet të jetë nga komunitetet tjera”.

Në bazë të asaj që u theksua më lartë, Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, i rekomandon Kuvednit të miratojë Projektligjin me amendamentet e propozuara.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-83 për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve, me raportin e Komisionit funksional për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-83 për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve të propozuara nga Komisioni funksional dhe kërkoj që komisioni të deklarohej nëse ka ndonjë propozim në amendamente, në mënyrë që vërejtjet të përfshihen në raport, i cili do t'i dërgohen Komisionit Funksional.

Meqë nuk kishte vërejte, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-83 për regjistrimin dhe evidencën e të papunësuarve dhe punëkërkesve dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

5. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-098 për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror, me raportin e Komisionit funksional për Buxhet dhe Financa, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-098 për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror të propozuara nga Komisioni funksional , dhe kërkoj që komisioni të deklarohej nëse ka ndonjë propozim në amendamente.

Meqë nuk kishte vërejte, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-098 për themelimin e Agjencisë për shërbimet e navigacionit ajror dhe ka konstatuar se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

6. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-168 për Turizmin dhe shërbimet turistike, me raportin e Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe industri, me amendamente.

Kryesuesi, paraqet për shqyrtim propozim amendamentet në Projektligjin nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-168 për Turizmin dhe shërbimet turistike të propozuara nga Komisioni funksional, dhe kërkoi që komisioni të deklarohet nëse ka ndonjë propozim në amendamente.

Meqë nuk kishte vërejte, Komisioni njëzëri nxori këtë:

R E K O M A N D I M

I..Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim ka shqyrtuar Projektligjin nr. 04/L-105 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-168 për Turizmin dhe shërbimet turistike dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve.

II Projektligji me amendamentet e propozuara nga komisioni Funksional, mund të procedohet për shqyrtim dhe për miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

Kryesuesi - Në fjalinë e tij tha se komisioni për Komunitete dhe Kthim ma anë të informatës me shkrim të datës. 28.2.2012, lidhur me Projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe iu është drejtuar komisionit funksional që edhe një herë të rishqyrtohet amendamentin 1, të nenit 4 dhe amendamentet tjera të propozuara nga Qeveria.

Komisioni Funksional i ka shqyrtuar sërish amendamentet e propozuara të komisionit për Komunitete dhe Kthim dhe kanë dalë me Përfundim se të njëjtat nuk i përkrahin dhe kanë marrë qëndrim se do të mbeten në fuqi amendamentet e Komisionit Funksional të datës 12.01.2012.

Kryesuesi –Ai propozoi që komisioni të caktojë një takim të veçantë ku do të shqyrtohen amendamentet kontestuese të Qeverisë.

Elmi Reçica- theksoi se lidhur me Projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe, komisioni ka përafruar qëndrimet e veta në takimet e përbashkëta me të dyja komisionet dhe në takim me të dy kryetarët dhe zëvendëskryetarët e komisioneve: Më pas shtoi se ka mbet kontestuese vetëm interpretimi gjuhësor i amendamentit 1, i nenit 4 të Qeverisë.

Më pas, e informoi komisionin se sot janë duke u zhvilluar bisedimet e palëve të interesuara të cilat janë përgjegjëse dhe vendimmarrëse në Projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe dhe të ligjeve tjera.

Në këtë vështrim në mbledhjen e radhës do të kemi informata shtesë ku do të shqyrtohen të gjitha vërejtët pastaj komisioni do të marr vendime adekuate.

Kryesuesi konstatoi se për arsye të vërejtjeve në amendamentet e propozuara nga Qeveria në Projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe, Komisioni nxori këtë:

Përfundim

- I. *Komisioni për Komunitete dhe Kthim do të mbaj mbledhje me datën 21.03.2012, dhe se do të shqyrtohet Raporti me amendamente i komisionit FunkSIONAL dhe propozim amendamentet e Qeverisë në Projektligjin për fshatin Hoçë e Madhe dhe se do të dalim me qëndrime konkrete.*

7. Të ndryshme.

Kryesuesi – theksoi se Komisioni do të organizoi dreke pune me datën 21.03.2012, ku do të adresohen pikat rreth organizimit të një vizite në Unionin Evropian.

Gjatë këtij takimi do të caktohen edhe datat për realizimin e vizitës në Kuvendin Komunal Ranillug dhe Komunën e Shtërpçës. Për takimin dhe agjendën e vizitës, komisioni do të njoftohet me kohë.

Mbledhja përfundoi në orën 14:30

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetar i Komisionit

Goran Marinkovic